



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Mars 2021

Nr: 165

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE
TË KOALICIONIT ALEANCA (AL), PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS
25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga koalicioni Aleanca (AL), për miratimin e listave shumëmemërore për zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 108, datë 02.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, koalicioni Aleanca (AL) është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, koalicioni Aleanca (AL) ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore, më datë 8.3.2021.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 138, datë 11.3.2021, vendosi kthimin për korrigjim të dokumentacionit, të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të subjektit zgjedhor, koalicioni Aleanca (AL).

Brenda afatit ligjor, subjekti zgjedhor koalicioni Aleanca (AL) depozitoi dokumentacionin e korrigjuar. Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të koalicionit Aleanca (AL) dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se nuk është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të procesit të verifikimit u rikonstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit. Koalicioni Aleanca (AL) nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni ka paraqitur vërtetimin për zotërimin e 2 (dy) mandateve në Kuvend. Partitë pjesëtare të koalicionit Aleanca nuk vërtetojnë se zotërojnë bashkërisht në Kuvend numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. Gjithashtu nuk janë paraqitur listat mbështetëse me jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare.

Kërkesa për miratimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Korçë, kandidati me numër rendor 3 dhe Qarku Tiranë, kandidati me numër rendor 31 z. Klajdi Bufi, nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor pasi nuk plotëson kriterin për t'u regjistruar si kandidat i listës shumemërore vetëm në një zonë zgjedhore.

Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të koalicionit Aleanca (AL), Model – 05, rezultojnë të plotësuar gabim për të gjitha zonat zgjedhore.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për deputet, të subjektit politik koalicioni Aleanca, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për deputetë, rezulton se përveç kandidatit të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.



1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Genci Sulçe Sakaj**, kandidat për deputet, qarku Vlorë, me numër rendor 2, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 434 datë 29.12.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 190/3, i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit me 3 vjet (tre) burgim dhe 1 000.000 (një milion) lekë gjobë. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i vendimit duke e konvertuar në 2 (dy) vjet kohë prove. Dënimi është amnistuar nr.1283 prot, datë 24.12.2012.

Pikës 2, “*A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me aktin administrativ nr. 7019 datë 23.09.2002, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e ka deklaruar fajtor dhe e ka pushuar nga puna për shkelje të procedurave doganore, parashikuar në VKM nr.205, datë 13.04.1999. Me aktin nr. 118/1 prot, datë 27.02.2002 Departamenti i Administratës Publike ka vendosur kthimin në punë të tij.

Nga verifikimi prima facie i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Genci Sulçe Sakaj**, kandidat për deputet Qarku Vlorë, me numër rendor 2, rezulton se vepra penale, parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal, përfshihet në fushën e veprimit sipas shkronjës “c”, pika 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidim, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët kryejnë me dashje një krim që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me **jo më pak se 2 vjet burgim**.

Ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 tij, parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit në varësi të llojit të veprës penale të cituar...

Për personat që parashikohen nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.



Referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga z. **Genci Sulçe Sakaj** kandidat për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në lidhje me veprën penale, parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal, të vendimit nr. 434, datë 29.12.2008, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, masës së dënimit për kryerjen e kësaj vepre penale është brenda periudhës së ndalimit për zgjedhjen në funksion, kandidat për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë, për Qarkun Vlorë.

Aktualisht referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, verifikimit prima facie të tyre, pa administruar ende përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, konstatohet se kandidati për deputet është në kushtet e ndalimit të kandidimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresat nr. 2208 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresat nr. 2206 prot., datë 17.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të subjektit zgjedhor koalicioni ALEANCA, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për deputet, të subjektit politik Koalicioni ALEANCA.

Gjithashtu vihen re parregullsi në dokumentacionin e kandidimit të kandidatëve për deputet në qarqet e poshtë përmëndura:

1. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Tiranë**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 07.
2. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Durrës**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet me numër rendor 1 dhe 15.
3. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Elbasan**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet me numër rendor 13, 14 dhe 15.



4. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Shkodër**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet me numër rendor 9 dhe 11.
5. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Fier**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet me numër rendor 1, 6, dhe 16.
6. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Kukës**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 2.
7. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Vlorë**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 1.
8. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Gjirokastrë**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet me numër rendor 2, 4 dhe 6.
9. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **qarku Lezhë**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 1.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore të koalicionit Aleanca (AL), për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,



V E N D O S :

1. Refuzimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca (AL) për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

